

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2025

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: : “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklorit Kalciumi për nevojat e shoqërisë”. – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV) (Klor - 24311900-6.**

- **VLERA E FONDIT LIMIT: 3 030 500 (Tre milion e tridhjet mijë e pesëqind ) Lekë PA TVSH**

---

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Autoriteti Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Lushnje Sh.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**1.1.Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**1.2. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** Sipas kriterëve të

përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit, pika 1 e shtojcës 7 të DT . Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

## **2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.1** Vërtetim xhiroje vjetore nga Administrata Tatimore për 2021-2022-2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur në qoftë se Operatorët Ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK si më lart.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e limit të kësaj kontrate, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 (i ndryshuar) "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", V.K.M. nr. 922 datë 29.12.2014, "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, etj. Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesi bilancet vjetore, përkatësisht për vitet financiare 2021, 2022, 2023 që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Shënim: Në respektim të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 43, pika 4,

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe neni 41, pika "c", e ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, në zbatim të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

**2.2.3** Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më vogël se 20 % e vlerës së përllogaritur të kontratës e cila prokurohet dhe që është realizuar gjatë 3 viteve të fundit, nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore; ose

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi, pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore;

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën minimalisht 20% të vlerës limit të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

## 2.4 Kapaciteti Teknik:

**2.4.1** Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Certifikatën ISO 9001:2015 (Për menaxhimin e cilësisë, e vlefshme për periudhën e tenderit dhe të perkthyer në shqip) ose ekuivalente me to, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020, ”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe me rekomandimin e A.P.P., datë 20.03.2018, prot 3341/1. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e A.K. t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

**ISO 9001 : 2015** parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

**2.4.2.** Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionet e mesipërme për ato elementet toksikologjike që realizon I.SH.P ose ekuivalente.

**Argumentimi:** Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përkthimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Sa më sipër në vlerësimin e Autoriteti Kontraktor ky kriter ligjor është i domosdoshëm pasi objekti i prokurimit për vetë natyrën e tij ka një impakt social të rëndësishëm pasi bëhet fjalë për ujin e pijshëm ndaj edhe garancitë që Autoriteti Kontraktor synon të përftojë me anë të vendosjes së kriterëve duhet të jenë të një niveli të lartë për të konkluduar me përmbushjen e suksesshme të kontratës objekt prokurimi. Në mbështetje të bazës ligjore të sipërpërmendur njësia e prokurimit gjykon se vendosja e kërkesës së mësipërme në kushtet e veçanta të kualifikimit Autoriteti Kontraktor ka për qëllim të vërtetojë se për produktet që prokurohen nuk do

të përmbajnë lëndë të huaja dhe toksike të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e popullatës (konsumatorëve).

**2.4.3** Me qëllim vërtetimin se produkti objekt prokurimi “Hipoklorit Natriumi”, është prodhuar nga prodhues të liçencuar, dhe se është në përputhje me specifikimet teknike e standartet e kërkuara, Operatori Ekonomik (Ofertuesi) duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

**1. Në rast se ofertuesi është vetë prodhues, duhet të paraqesë:**

- Çertifikatën që vërteton konformitetin e produktit me standardin SSH EN 901: 2013 “Kimikate që përdoren për trajtimin e ujërave të destinuara për konsum njerëzor” - Leje mjedisore e tipit A të lëshuar nga Ministria e Mjedisit për kimikatin e kërkuar

**2. Në rast se ofertuesi nuk është vetë prodhues, duhet të paraqesë: - Autorizim të prodhuesit për ofertuesin ose autorizim për ofertuesin nga distributori i autorizuar prej prodhuesit ose që ka lidhur Marrëveshje Bashkëpunimi me prodhuesin (ose ekuivalenti i tij/saj) sipas ligjit. Gjithë këto dokumente duhet të kenë afat vlefshmërie për gjithë kohëzgjatjen e kontratës të kësaj procedure prokurimi, i cili duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Ku në rast se autorizimi është lëshuar nga distributori duhet të paraqitet edhe Autorizimi/ Marrëveshja e bashkëpunimit midis distributorit dhe prodhuesit, e cila duhet të jetë e vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit.**

- **Çertifikatën e origjinës**, cilësisë dhe Skedë teknike të lëshuara nga institucione të autorizuara ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produktit të prodhuar me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.

- **Lejen e importit** të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për llojin e kimikatit, në rast se ofertuesi është vetë importues, dhe në rast se nuk është vetë importues, duhet të paraqesë kontratën e furnizimit me një importues të këtij malli i cili disponon lejen e importit.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi dhe duke vlerësuar rëndesinë dhe ndjeshmerinë e objektit të kontratës pasi kemi të bëjmë me substance e Klorit e cila do të përdoret për trajtimin e ujit të pijshëm, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës plotësojnë kërkesat e legjislativës specifike për realizimin e kontratës. Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e certifikatës nga prodhuesi, lejes mjedisore, licensat dhe makinerinë e kërkuar kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues.

(shënim - përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar).

Gjithashtu kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar neni 40, pika 6, germa “c”, i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë

t'u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi. Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur Autoriteti Kontraktor garantohet dhe fiton siguri se Operatori Ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

**Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim Në zbatim të neneve 36, 37 të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” përfshihet termi “ekuivalent”.**

**Sqarim për ofertuesit: Në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” Neni 82 dhe VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 26, Neni 39, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, Autoriteti Kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në Nenin 82, të LPP-së dhe Nenit 26 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar. Në çdo rast, Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të noterizuara me origjinalin.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Për objektin e prokurimit: “Blerje klori”.

### **Specifikimet teknike gjenden pjesë përbërëse e D.T. në S.P.E. e A.P.P.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**